



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2023:301070

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06352462

C.nr.3712/23

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edona Zuzaki, me bashkëpunëtorin profesional Milot Mehmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses SH.A nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.B<sup>1</sup>, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit Gjilan, me objekt kontesti kompensimi në emër të kualifikimit dhe inflacionit në pagë, vlera e kontestit 3,216.42 euro, jashtë seancës, me datë 16.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses SH.A nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit Gjilan, që në emër të kualifikimit bachelor për periudhën 01.12.2020 – 31.01.2023, për 26 muaj, duke llogaritur nga 55.35 euro për çdo muaj, t'ia paguaj shumën prej 1,439.10 euro dhe në emër të inflacionit në pagë për periudhën kohore 01.12.2020 – 31.10.2022, duke llogaritur pagën bazë të paditësit prej 421.00 euro, t'ia paguaj shumën prej 660.96 euro, apo shumën e përgjithshme prej 2,100.06 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 15.12.2023 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, e kërkuar për periudhën kohore 01.01.2020 – 30.11.2020, sa i përket të dy kërkesave si dhe periudhës prej 06.02.2023 – 31.10.2023, sa i përket kërkesës për kualifikim, në shumën e përgjithshme prej 1,116.36 euro.

III. DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia paguaj paditëses shumën prej 144.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

---

<sup>1</sup> Në padinë fillestare është përfaqësuar me autorizim nga avokati F.S, i cili me email të datës 06.08.2024 ka njoftuar gjykatën se më datë 30.07.2024 ka dhënë betimin për noter, e me këtë rast ka dhënë dorëheqje nga pozita e avokatit. Për të gjitha lëndët civile ku ka qenë i autorizuar ka njoftuar se autorizimin ia ka bartur avokatit K.B. Në autorizimin e bashkëngjitur shkresave të lëndës konstatohet përmbajtja “Nëse i autorizuari në fjalë për shkak të pengesave objektive nuk mund t'i ushtrojë autorizimet e dhëna nga unë, atëherë këtë autorizim mund ta bartë në persona të tretë pa pasur nevojë për pëlqimin tim si autorizimdhënës”.

## A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të tij, më datë 15.12.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin në emër të kualifikimit dhe inflacionit në pagë, në vlerë të kontestit prej 3,216.42 euro.

Në padi ka theksuar se e njëjta është e punësuar në Institucionin Parshkollor (në vijim: IP) “Ardhmëria 2” në Gjilan, në cilësinë e edukatores, ndërsa asnjëherë nuk është kompensuar nga e paditura për diferencën në pagë për shkak të kualifikimit/licencimit dhe përqindjes sipas inflacionit, përkundër që ky detyrim i takon të paditurës sipas Kontratës Kolektive të Arsimit dhe Vendimit të Qeverisë. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës prej 2,546.10 euro, në emër të diferencës për licencim për periudhën 01.10.2020 – 31.10.2023 dhe shumës prej 670.32 euro, në emër të inflacionit për periudhën 01.01.2020 – 31.10.2022. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 40.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për shkak të kualifikimit/licencës dhe inflacionit në pagë, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin merititor me të cilën refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie punë të e paditura (fakt i vërtetuar nga kontrata e punës në kohë të pacaktuar e lidhur mes paditëses dhe të paditurës, nr.prot.186/02.11.2022 e dt.01.09.2022, dhe vërtetimi me nr.prot.33/2020 i dt.18.06.2020 lëshuar nga IP “Ardhmëria 2” Gjilan).

Nuk është kontestuese se i njëjti ka diplomë të nivelit bachelor nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimi (fakt i vërtetuar edhe nga diploma nr.709 e dt.20.05.2016), dhe se pagën bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro, ndërsa për kualifikim është paguar në shumën prej 58.32 euro (fakt i vërtetuar edhe nga lista e lëshuar në emër të paditësit nga Buxheti i Republikës së Kosovës).

Nuk është kontestuese se përqindja e shkallës së inflacionit sipas entit të statistikave për vitin 2020 është 0.2 %, për 2021 është 3.4 %, ndërsa për vitin 2022 është 11.6 % (fakt i provuar nga të dhënat e lëshuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I dhe jo themelësia e refuzuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe në Kontratat Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendës drejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, në nenin 3, paragrafi 2 është përcaktuar se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; dhe nenin 35, paragrafi 10 se: “Për çdo vit të përcillet shkalla e

inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017 – 21.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Nga këto, gjykata vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë paditësit, pasi gjeti se i njëjti ka kërkuar kompensimin e kualifikimit-licencimit dhe infacionit edhe për periudhë pjesërisht të përfshirë në parashkrim, edhe për periudhë të përfshirë në skadim të vendimit të qeverisë.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë paditësit, pasi ka gjetur se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësit pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me Master, meqë është paguar në shumën prej 58.32 euro për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagës), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet në shumën me përqindjen prej 27 %; si dhe gjeti se e paditura nuk ia ka kompensuar inflacionin në pagë paditësit, përkundër se shkalla e inflacionit është përkufizuar me Entin e Statistikave të Kosovës.

Lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata e bazoi në diferencën e shumës së papaguar sa i përket kompensimit për shkak të kualifikimit për periudhën 01.12.2020 – 31.01.2023 dhe përqindjes së shkallës së inflacionit në vlerën e pagës bazë së paditësit për periudhën 01.12.2020 – 31.10.2022.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi vlerëson se periudha kohore e kërkuar për këtë kompensim është pjesërisht e përfshirë në parashkrim. Duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, kërkesa e paditësit llogaritet 3 vite mbrapa nga data e parashkrimit të kërkesës. Meqë padia është ushtruar më datë 15.12.2023, në bazë të kësaj dispozite ligjore, kërkesa duhet llogaritur nga data 01.12.2020, ndërsa paditësi kompensimin e ka kërkuar nga data 01.01.2020. Në rastin konkret periudha 01.01.2020 – 30.11.2020, është e përfshirë në parashkrim.

E në fakt, sa i përket kërkesës për kompensimin e kualifikimit, paditësi ka kërkuar këtë kompensim përtej skadimit të vendimit të qeverisë, përderisa me mendimet juridike të theksuara si më sipër është përcaktuar në mënyrë të qartë se vendimi i qeverisë zbatohet deri më datë 06.02.2023, ndërsa paditësi kompensimin sipas kësaj kontrate e ka kërkuar deri më datë 31.10.2023, prandaj periudha 06.02.2023-31.10.2023 është e përfshirë në skadim.

Ndërsa, sa i përket inflacionit të njëjtën e ka kërkuar deri më datë 31.10.2022, përderisa kontrata zbatohet deri më datë 21.11.2022, mirëpo çdo vendosje ndryshe do të përbënte tejkalim të kërkesëpadisë.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se Vendimi i Qeverisë është zbatuar sipas detyrës zyrtare, gjykata vlerëson se nuk qëndron ky pretendim pasi vendimi nuk është zbatuar në tërësi nga ana e të paditurës si punëdhënëse, përkatësisht të punësuarit janë paguar pjesërisht sipas kualifikimit të tyre, e jo mbi bazën e përqindjes siç e rregullon ky vendim. Edhe sa i përket pretendimit të të paditurës se inflacioni nuk mund të kërkohej vetëm në një sektor të punës, gjykata vlerëson se me kontratë kolektive është përcaktuar se inflacioni ka ndikim në pagën e mësimdhënësve – të punësuarve si në nenin 3.2 të KKAK-së, prandaj edhe këtë pretendim e gjeti të pabazuar.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil  
C.nr.3712/23, më datë 16.10.2024

Gjyqtarja,  
Edona Zuzaki

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.